AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 41/523-13 **Prot.**
Nr. Dok. 202503871/11

Tiranë 16/2/**2026**

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave për koordinimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe vlerësimin serioz të mënyrës sesi trajtohen çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve.*

BASHKISË KUKËS

Të nderuar,

Avokati i Popullit si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, shërben si garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjatë, si dhe të personave pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, institucioni i Avokatit të Popullit i kushton një vëmendje të posaçme dhe ndjek e trajton me prioritet mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të grupeve në nevojë.

Siç jeni në dijeni nga komunikimet e mëparshme institucionale, shtetasi Sami Halil Koldashi, me banim në fshatin Tjedrinë, Ujmisht, Kukës, me aftësi të kufizuara, trajtohet me pagesë paaftësie për shkak të problemeve shëndetësore. Ai parashtron se trajtohet me ndihmë ekonomike, e cila ka pësuar luhatje të vazhdueshme duke pësuar ulje në masën e përfituar. Qytetari thekson se ndodhet në kushte shumë të

vështira ekonomike dhe shëndetësore, nuk ka burime të tjera të ardhurash dhe se edhe një diferencë minimale në masën e ndihmës ekonomike ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetesën e tij. Ai pretendon mungesë vëmendjeje dhe mbështetjeje nga ana e Njësisë Administrative Ujmisht dhe Bashkisë Kukës

Sa më sipër ka kërkuar ndihmën e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të kësaj kategorie në nevojë.

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore, Avokati i Popullit, pasi është njohur me objektin e ankesës të sipërcituar, vendosi marrjen në shqyrtim të saj dhe nisjen e hetimit administrativ, referuar përcaktimeve të ligjit nr. 8485, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" të ndryshuar[1]. Në kuadër të hetimit administrativ për zgjidhjen e drejtë të kësaj çështje, në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor[2] i ka kërkuar Bashkisë Kukës[3] dhe Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror[4], shpjegime mbi këtë rast, në mënyrë të përsëritur.

Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social ka përcjellë informacion lidhur me rastin duke na informuar si më poshtë:

Familja e z. Sami Halil Koldashi është përfituese në sistemin e Ndihmës Ekonomike (NE) me numër aplikimi NE-2018-094694, që nga muaji tetor 2018, aktualisht me vlerë 1,288 lekë në muaj. Gjithashtu, z. Sami Halil Koldashi është përfitues i pagesës së paaftësisë së kufizuar me vlerë 11,944 lekë në muaj.
Nga muaji tetor 2018 deri në janar 2021 ka përfituar 1,800 lekë në muaj, vlerë kjo e përllogaritur sipas sistemit të pikëzimit të Ndihmës Ekonomike.
Nga muaji shkurt 2021 deri në qershor 2021 ka përfituar 3,600 lekë në muaj, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 10.02.2021, "Për një shtesë në vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave 'Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike'". Në

---

[1] Neni 13, paragrafi i pare: *"Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike".*

[2] Neni 63, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*, si dhe nenit 19 pika b, Ligji Nr.8454 , date 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku përcaktohet: *"Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin".*

[3] Shkresë nr. K1/S23-2 Prot. datë 27.11.2025, "Kërkesë për shpjegime". Shkresë nr. K1/S23-5, datë 12.12.2025, "Kërkesë e përsëritur për informacion". Shkresë nr. K1/S23-9, datë 29.12.2025 "Kërkesë e përsëritur për informacion". Shkresë nr. K1/S23-10, datë 16.01.2026 "Kërkesë e përsëritur për informacion".

[4] Shkresë nr. K1/S23-3 Prot. datë 27.11.2025, "Kërkesë për shpjegime". Shkresë nr. K1/S23-6, datë 12.12.2025, "Kërkesë e përsëritur për informacion".

Kreun III, pika 15, parashikohet se për përfituesit e ndihmës ekonomike, të përcaktuar në shkronjat "a", "b", "c", "ç" dhe "d" të pikës 2 të Kreut I të këtij vendimi, masa e ndihmës ekonomike dyfishohet për një periudhë 6-mujore, me qëllim zbutjen e efekteve të shkaktuara nga epidemia COVID-19.
Nga muaji korrik 2021 deri në dhjetor 2021 ka përfituar 1,800 lekë në muaj, vlerë kjo e përllogaritur sipas sistemit të pikëzimit të Ndihmës Ekonomike.
Nga muaji janar 2022 deri në shtator 2022 ka përfituar 1,980 lekë në muaj, vlerë kjo e përllogaritur sipas sistemit të pikëzimit të Ndihmës Ekonomike.
Nga muaji tetor 2022 deri në prill 2024 ka përfituar 2,178 lekë në muaj, vlerë kjo e përllogaritur sipas sistemit të pikëzimit të Ndihmës Ekonomike.
Nga muaji maj 2024 deri në qershor 2024 ka përfituar 3,466 lekë në muaj, rritje kjo e bërë sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 8, datë 14.01.2015, "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kËh në muaj". Në pikën I të këtij vendimi parashikohet kompensimi i diferencës së çmimit të energjisë elektrike për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, si dhe për familjet që kanë në përbërje anëtarë me aftësi të kufizuar, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-it, sipas pikës 3 të nenit 7 të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, kur personi me aftësi të kufizuar është kryefamiljar dhe nuk ka anëtarë të familjes të punësuar ose të vetëpunësuar.
Nga muaji korrik 2024 e në vazhdim, familja përfiton 1,288 lekë në muaj, pra vetëm vlerën e kompensimit të energjisë elektrike, pasi sipas ligjit nr. 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", Kreu III, neni 12, pika 6, përcaktohet se anëtarit të familjes në nevojë, që është person me aftësi të kufizuar, invalid pune apo individ përfitues i ndihmës ekonomike, nuk i llogaritet masë ndihme ekonomike në strukturën e masës së ndihmës ekonomike për familjen.
Familja e z. Sami Halil Koldashi, në rast donacionesh nga shoqata apo biznese të ndryshme, do të trajtohet me prioritet nga ana jonë.

Nga ana tjetër, Bashkia Kukës, nuk i ka kthyer asnjë përgjigje kërkesave të përsëritura për informacion dhe shpjegime të Avokatit të Popullit.

Nga krahasimi me praktikat e konsoliduara të vendeve të Bashkimit Evropian, situata e konstatuar në rastin e Bashkisë Kukës përfshin tre elemente klasike të keqadministrimit administrative: (i) mosinformimin e qytetarit, që përbën shkelje të së drejtës për transparencë; (ii) mosverifikimin e fakteve dhe rrethanave konkrete të çështjes, që cënon parimin e kujdesit, objektivitetit dhe paanshmërisë administrative; si dhe (iii) mosbashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit, që përbën

shkelje të drejtpërdrejtë të detyrimit ligjor për bashkëpunim institucional[5]. Sipas praktikës së European Ombudsman[6], refuzimi, vonesa ose shmangia e përgjigjes ndaj kërkesave të një institucioni mbikëqyrës përbën, në vetvete, formë keqadministrimi[7], pavarësisht nga fakti nëse informacioni i nevojshëm për sqarimin e qytetarit është siguruar pjesërisht nga një institucion tjetër. Kodi Evropian i Sjelljes së Mirë Administrative[8] shërben si standard referues për vlerësimin e administrimit të mirë dhe të sjelljes administrative, duke përcaktuar detyrimin e administratës për veprim të ligjshëm, të paanshëm, transparent dhe brenda afateve të arsyeshme. Në këtë kuptim, moskthimi i përgjigjeve nga Bashkia Kukës ndaj kërkesave të përsëritura të Avokatit të Popullit përbën një qëndrim refuzues për bashkëpunim, në kundërshtim me standardet evropiane të administrimit të mirë, ku vetëm elementi i mosbashkëpunimit institucional mjafton për ta cilësuar sjelljen administrative si keqadministrim serioz.

Punonjësit e Bashkisë duke mos përmbushur detyrimin ligjor në marrëdhënien me institucionin e Avokatit të Popullit, janë bërë në këtë mënyrë pengesë për institucionin e Avokatit të Popullit në ushtrimin e detyrës për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, në mënyrë sa më efiçente dhe në një afat sa më të arsyeshëm. Në këtë kuptim, qasja refuzuese ndaj bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit krijon dyshime të arsyeshme se kjo sjellje reflektohet edhe në marrëdhënien e bashkisë me qytetarët.

Lidhur me qëndrimin e punonjësve të Bashkisë Kukës, me rastin objekt shqyrtimi ky përbën tregues të shkeljes së parimeve themelore të veprimtarisë administrative, si parimi i ligjshmërisë, transparencës dhe informimit, për sa kohë qytetari nuk është vënë në dijeni në mënyrë të qartë dhe të arsyetuar mbi kriteret dhe shkaqet e ndryshimit të masës së ndihmës ekonomike. Po ashtu, rezulton i cënuar parimi i dhënies së ndihmës aktive, pasi organet përgjegjëse nuk kanë ofruar orientimin dhe mbështetjen e nevojshme për një person në kushte të theksuara vështirësie ekonomike dhe shëndetësore. Më tej, veprimet dhe mosveprimet e konstatuara

---

[5] Qëndrimi refuzues për të bashkëpunuar me institucionin e Avokatit të Popullit, vjen në kundërshtim me: (i) pikën 4, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: *"Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij"*; *(ii) nenin 19/b të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", që parashikon se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qëndrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin"*, si edhe *paragrafin e fundit të këtij neni, ku parashikohet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme."*;

[6] https://edt.europa.eu/en/ombudsman-procedure?utm_source

[7] https://www.ombudsman.europa.eu/en/make-a-complaint

[8] Standardet evropiane të administrimit të mirë, të konsoliduara në nenin 41 të Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe në Kodin Evropian të Sjelljes së Mirë Administrative të Ombudsmanit Evropian, (https://www.ombudsman.europa.eu/en/publication/en/3510), parashikojnë detyrimin e administratës publike për transparencë, përgjigje brenda afateve të arsyeshme dhe bashkëpunim me institucionet mbikëqyrëse. Mosrespektimi i këtyre parimeve konsiderohet keqadministrim administrativ.

ngrenë dyshime mbi respektimin e parimit të drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efiçencës, duke qenë se procedura nuk ka garantuar trajtim të barabartë, vendimmarrje të arsyetuar, si dhe një reagim administrativ të shpejtë dhe proporcional me nevojat reale të qytetarit, në kundërshtim me sa parashikon Ligji nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"[9].

Për adresimin efektiv të problematikave të konstatuara dhe për përmirësimin e qasjes së qytetarëve në shërbimet publike, organet e pushtetit vendor, në cilësinë e institucioneve përgjegjëse më afër komunitetit, duhet të ushtrojnë kompetencat e tyre në përputhje me standardet më të larta të qeverisjes lokale[10], duke respektuar parimin e subsidiaritetit. Ky parim kërkon që vendimmarrja dhe ofrimi i shërbimeve të bëhet në nivelin më afër qytetarit, me qëllim që nevojat të adresohen sa më drejtëpërdrejt dhe efektivisht. Referuar dispozitave të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" [11], e konkretisht neni 3 i të cilit përcakton: *"Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve,* është në misionin e organeve të qeverisjes vendore e kryesisht të bashkive, që të sigurojnë qeverisje të efektshme, efikase dhe sa më pranë komuniteteve, në mënyrë që t'u krijojnë atyre informacionin e nevojshëm dhe aksesin, në lidhje me ofrimin e mbështetjes sociale për një jetë të përshtatshme e dinjitoze.

Organet e qeverisjes vendore, përkundrejt ankuesve por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësi duhet të garantojnë standardin e nevojshëm për qeverisje, garanci social ekonomike për qytetarët e grupet në nevojë dhe standardin e nevojshëm të garantimit të të drejtave thelbësore të qytetarëve. Organi i pushtetit vendor duhet të reflektojë një sjellje e cila të mos jetë përjashtuese apo diskriminuese kundrejt grupimeve të caktuara të qytetarëve të cilët kanë të drejta të barabarta pavarësisht gjendjes apo përkatësisë ekonomike, sociale, kulturore, etnike, arsimore, etj. Bashkia duhet të mbështesë dhe të vërtetojë qasjen apo sjelljen që ka pasur dhe ka ndaj qytetarëve në këto raste të vështira humane.

---

[9] Parimet e ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efiçencës, të parashikuara në nenet 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15 dhe 18 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", *detyrojnë administratën publike të veprojë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, në mënyrë transparente dhe të arsyetuar, duke informuar dhe ndihmuar aktivisht qytetarët, duke garantuar trajtim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe duke ushtruar veprimtarinë administrative në mënyrë të thjeshtuar, efikase dhe brenda një afati të arsyeshëm.*

[10] Karta Europiane e Autonomisë Vendore (neni 3, neni 4/3), ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr.8548, datë 11.11.1999.

[11] Ligji nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 3 përcakton: *"Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet: a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive; b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose nëligje të tjera; c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore; d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore; e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative".*

Vlen të theksojmë se në praktika të tjera administrative, kur njësitë e vetëqeverisjes vendore[12] kanë mbajtur një qasje proaktive dhe bashkëpunuese, duke trajtuar me seriozitet ankesat e qytetarëve dhe duke rivlerësuar në mënyrë objektive situatat ekonomike dhe sociale të paraqitura, këto raste janë zgjidhur në mënyrë efikase dhe në përputhje me parimet e administrimit të mirë. Përfshirja aktive e bashkisë në procesin e verifikimit dhe komunikimit me qytetarin ka kontribuar në sqarimin e plotë të rrethanave, në rivendosjen e besimit të publikut ndaj administratës dhe në shmangien e përshkallëzimit të mëtejshëm të problematikave. Në këtë kontekst, bashkëpunimi institucional me Avokatin e Popullit dhe trajtimi i kërkesave për informacion brenda afateve ligjore përbëjnë elementë thelbësorë për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe për zbatimin efektiv të standardeve të administrimit të mirë.

Parë në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit vlerëson se është e nevojshme marrja e masave për një vlerësim serioz të mënyrës sesi trajtohen nga institucioni i Bashkisë çështjet që prekin të drejtat e qytetarëve, me prioritet shtresat në nevojë, duke patur një qasje proaktive, bashkëpunuese dhe shkëmbim të plotë dhe shterues të informacioneve të nevojshme bazuar në përcaktimet ligjore, për zgjidhjen e rasteve që i përkasin qytetarëve.

Në përfundim, Avokati i Popullit në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike", si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku thuhet se: "Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive";

REKOMANDON:

1. ✓ *Marrjen e masave për rivlerësim të kujdeshëm të situatës social ekonomike të familjes së qytetarit në nevojë dhe trajtimin e rastit në përputhje me parashikimet ligjore*
2. ✓ *Marrjen e masave për realizimin e një analize institucionale të thelluar mbi standardet e trajtimit administrativ të çështjeve që prekin të drejtat e qytetarëve, nga institucioni juaj dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, duke garantuar qasje proaktive, koordinim ndërinstitucional dhe transparencë të plotë në shkëmbimin e informacionit dhe në vendimmarrje, me qëllim*

[12] Ankesë nr. 202301054 D.H. ndaj Bashkisë Kukës; Ankesë nr. 202400016 T.K. ndaj Bashkisë Fier; Ankesë nr. 202503782 I. M ndaj Bashkisë Shijak; Ankesë nr. 202503200 V.H dhe V.H ndaj Bashkië Berat etj...

sigurimin e zgjidhjeve efektive dhe prioritizimin e grupeve në situatë vulnerabiliteti..

3. *Marrjen e masave për koordinimin dhe rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional me institucionin e Avokatit të Popullit.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454 datë 4. 2.1999 "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t'i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditëve nga data e dërgimit.

Për, sa më sipër, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe na informoni për qëndrimin tuaj ndaj tij në një afat të arsyeshëm dhe ligjor.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

KOMISIONER

VILMA SHUKRDHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - AVOKATI I POPULLIT